

VENDIM
Nr. 74, datë 1.2.2013

PËR VIJIMIN E PROCEDURAVE TË PRIVATIZIMIT TË SHOQËRISË
“ALBPETROL” SHA, PATOS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7 të ligjit nr. 10 490, datë 15.12.2011 “Për përcaktimin e formës dhe të strukturës së formulës së privatizimit të shoqërisë Albpetrol” sh.a. Patos”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Të shpallë të mbyllura negociimet e kontratës së shitjes së aksioneve ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe shoqërisë fituese të tenderit të privatizimit “Vetro Energy PTE Ltd.”, për shkak të dështimit të kësaj shoqërie në nënshkrimin brenda afateve ligjore të kontratës së shitjes së aksioneve të shoqërisë “Albpetrol” sh.a.

2. Autorizimin e Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës të fillojë, në përputhje me parashikimet e vendimit nr. 107, datë 1.2.2012 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave për paraqitjen, hapjen dhe vlerësimin e ofertave për privatizimin e shoqërisë “Albpetrol” sh.a. Patos”, negociimet e kontratës së shitjes së aksioneve me kandidatët e tjerë sipas klasifikimit të përcaktuar në vendimin nr. 634, datë 3.10.2012 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e raportit përfundimtar të vlerësimit të ofertave dhe shpalljen e fituesit të tenderit për privatizimin e shoqërisë “Albpetrol” sh.a. Patos”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha